

Tiranë, më 13.01.2021

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR  
"MEDICINUS" SHPK**

Sot më datë 13.01.2021 unë e nënshkruara Mirsije Resul MOSHA, shtetase shqiptare lindur më datë 04.12.1994 në Kavajë, banuese në Tirana në adresën rruga Henrik Lacaj, Astir, Tirana, mbajtëse e pasaportës me nr BE5854863 në përputhje me Ligjin Nr.9901, me datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" ndërmarr hapjen dhe krijimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuara me emërtimin "MEDICINUS Sh.p.k (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

**KAPITULLI I  
EMRI I SHOQËRISË, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI**

**NENI 1**

**Emri I Shoqerisë**

Shoqëria është Person Juridik Privat, e themeluar ne formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuara nën emrin "MEDICINUS" SH.P.K

**NENI 2**

**Selia**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rr. Aleksandr i Madh, Pallati Y&S, Shk.1, Ap.23, Tirana, Shqipëri. Asambleja e përgjithshme e Shoqërisë (Ortaku i vetëm) mund të vendosë të transferojë selinë e Shoqërisë në një adresë tjeter. Organi administrues i Shoqërisë



mund të themelojë ose mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

### **NENI 3**

#### **Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të pacaktuar.

### **NENI 4**

#### **Objekti I Shoqërisë**

- 1) Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktivitetave që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjisacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqiperisë, duke u fokusuar kryesisht në:
  - a) Ofrimin e shërbimeve mjekësore dhe shërbime mjekësore diagnostikuese:
    - Ortopedi, Reumatologji, Okulistikë, Dermatologji, Stomatologji, Imazheri, Laborator, Logopedi, Psikologji, Farmaci, Nutricion.
  - b) Ofrimin e shërbimeve shëndetësore fizioterapeutike, kryesisht në fushat e mëposhtme:
    - Fizioterapi Kardio-pulmonare, Fizioterapi Ortopedike, Fizioterapi Muskulo-skeletike, Fizioterapi në Neurologji, Elektro-fiziologji, Fizioterapi në Pediatri, Fizioterapi në Geriartri, Fizioterapi në Sporte, Rehabilitim në Komunitet.
- 2) Import/eksport materiale mjekësore, fizioterapeutike, ortopedike dhe sportive.
- 3) Shitje/blerje me shumicë dhe pakicë të materialeve mjekësore, fizioterapeutike dhe ortopdike.
- 4) Shërbime akademike, trajnime profesionale brenda dhe jashtë vendit.
- 5) Ndërtim dhe Administrim të qendrave me aktivitet ne fushën e mjeksisë.
- 6) Cdo aktivitet fitimprurëse për shoqërinë, sipas licensimit dhe hapsirave ligjore përkatëse.



## **KAPITULLI II**

### **KAPITALI I SHOQËRISË**

#### **NENI 5**

##### **Kapitali**

Kapital I shoqërisë është 100.000 (njëqindmijë) lekë, i përbërë nga 1 (nje) kuotë.

#### **NENI 6**

##### **Kuotat e Kapitalit dhe zotërimi i tyre**

1. Kapitali është I përbërë nga 1 (një) kuotë, me vlerë nnominale 100.000(njeqindtëmijë) lekë/kuota në zotërim të plotë të ortakut të vetëmtë Shoqërisë Znj.Mirsije Mosha.

#### **NENI 7**

##### **Zmadhimi i kapitalit**

1. Asambleja e përgjithshme (ortaku i vetëm) mund të rrisë pa kufi kapitalin e Shoqërisë.
2. Administratori njofton për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, vendimin për zmadhimin e kapitalit. Vendimi publikohet në faqen e internetit të Shoqërisë.
3. Zmadhimi i kapitalit bëhet efektiv në datën e regjistrimit të realizimit të tij, në qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

#### **NENI 8**

##### **Zmadhimi i kapitalit me aktive të Shoqërisë**

1. Pas miratimit të bilancit të vitit paraardhës, asambleja e përgjithshme mund të vendosë të zgjerojë kapitalin e regjistruar, duke kaluar në kapitalin bazë rezervat e disponueshme dhe fitimet e pashpërndara.
2. Pjesa e rezervave që shkon përtej 1/10 së kapitalit të regjistruar, si dhe fitimet e pashpërndara mund të kalohen në kapitalin fillestare.



3. Rezervat dhe fitimi i pashpërndarë nuk mund të kalohen në kapitalin bazë nëse bilanci i vitit paraardhës rezulton me humbje.

## NENI 9

### Zvogëlimi i kapitalit themeltar

1. Asambleja e përgjithshme (ortaku i vetëm) mund të reduktojë kapitalin themeltar. Në cdo rast kapitali themeltar nuk mund të reduktohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
2. Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga administratorët. Ky vendim publikohet në faqen e internetit të shoqërisë.

## NENI 10

### Tranferimi i kuotave

1. Tranferimi i kuotave të kapitalit dhe e drejta e parablerjes. Kuotat e kapitalit tmund t'u transferohen të tretëve tërësisht ose pjesërisht, vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme (ortakut të vetëm)

## NENI 11

### Pasojat e kalimit të kuotave

1. Personi që e kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj Shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga casti i kalimit të kuotave, deri në castin e regjistrimit dhe kalimit.



## **KAPITULLI III**

### **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME, ADMINISTRIMI, KONTROLI**

#### **NENI 12**


##### **Të drejtat dhe detyrimet**

1. Asambleja e përgjithshme (ortaku i vetëm) është përgjegjës për marrjen e vendimeve për Shoqërinë për cështjet e mëposhtme:
  - a. Përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë,
  - b. Ndryshimet e statutit,
  - c. Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve,
  - d. Emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar,
  - e. Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shronjat “c” dhe “d” të kësaj pike,
  - f. Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë
  - g. Përgatitjen e pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë,
  - h. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit,
  - i. Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre,
  - j. Përfaqësimin e Shoqërisë në Gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve,
  - k. Riorganizimin dhe shpërbërjen e Shoqërisë,
  - l. Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë,
  - m. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë,
  - n. Cështjë të tjera të parashikuara nga ligji.

#### **NENI 13**

##### **Administrimi**

1. Shoqëria administrohet nga Administratori. Ky funksion do të kryhet nga ortaku i vetëm Znj. Mirsije Mosha, me një mandat 5 (pesë) vjecar me të drejtë ripërtëritje.
2. Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:
  - a. Kryejë të gjitha veprimet e adminstrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme ,
  - b. Përfaqësojë Shoqërinë,
  - c. Kujdeset për mbajtjen e saktë të dokumentave dhe të librave kontabël të Shoqërisë,
  - d. Përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku propozimet për



- shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumenta para asamblesë së përgjithshme për miratim,
- e. Krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarvajtjen e veprimtarisë dhe egzistencës së Shoqërisë,
  - f. Raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e e veprimeve të posacme me rëndësi të vecantë për veprimtarinë e Shoqërisë.
  - g. Kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënrat e detyrueshme të Shoqërisë sic parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit,
  - h. Kryejë detyra të tjera të përcaktaara në ligj dhe në statut.

#### **NENI 14**

##### **Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia**

1. Administratori detyrohet të kryejë detyrat e përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim dhe në interesim të mirë të Shoqërisë në tërësi. Administratori përgjigjet ndaj Shoqërisë për cdo veprim që vjen në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale.

#### **KAPITULLI IV**

#### **SHPËRNDARJA E FITIMIT**

#### **NENI 15**

##### **Shpërndarja e fitimit**

1. Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të Shoqërisë.
2. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.



## **KAPITULLI V**

### **PRISHJA E SHOQËRISË**

#### **NENI 16**

##### **Shkaqet e prishjes së Shoqërisë**

1. Shoqëria prishet:
  - a. Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj,
  - b. Me vendim të asamblesë së përgjithshme (ortakut të vetëm),
  - c. Me hapjen e procedurave të falimentimit,
  - d. Nëse nuk kryen veprimitari tregtare për dy vjet,
  - e. Me vendim të gjykatës.

#### **DISPOZITA KALIMTARE**

#### **NENI 17**

Ky statut hartohet dhe nënshkruhet në gjuhën shqipe, në 4 (katër) kopje me vlerë të njëjtë ligjore.

Ortakët e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

MEDICINUS Sh.p.k

Mirsije Mosha

*Mirsije Mosha*  
*Mosha*